



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 8, datë 28 03.2024

PËR

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT PLANI STRATEGJIK I INSPEKTIMIT PËR OFRUESIT
E SHËRBIMEVE POSTARE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1.	Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
2.	Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
3.	Z. Lorenc	Bako	Anëtar
4.	Z. Bleron	Dokle	Anëtar
5.	Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 28.03.2024, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullore e Brendshme e ndryshuar “Për Funkionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postar”, miratuar me Vendimin Nr.18 datë 19.12.2023 të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të grupit të inspektimit të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT PLANI STRATEGJIK I INSPEKTIMIT PËR OFRUESIT
E SHËRBIMEVE POSTARE”**

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 46/2015, datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”,

(ligji nr.46/2015) Neni 9 dhe 60;

2. Neni 46 i ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (ligji 10433/2011);
3. Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015);
4. Rregullore Nr. 45, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë të Ofruesve të Shërbimeve Postare”;
5. Rregullore e Brendshme e ndryshuar “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postar”, miratuar me Vendimin Nr.18 datë 19.12.2023 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacionin shpjegues mbi çështjen në shqyrtim;
2. Projekt Vendimin e formatuar dhe arsyetuar;

Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e:

Dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit për Ofruesit e Shërbimit Postar për vitet 2024-2026”, është hartuar me qëllim, rregullimin e veprimtarisë inspektuese të AKEP sipas Ligjit nr. 46/2015, datë 07.05.2015 “Për Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores Nr. 45, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë të Ofruesve të Shërbimeve Postare”.

Dokumenti i përgatitur përcakton drejtimet dhe objektivat kryesore të inspektimit në terma afatgjatë (3 vjet) dhe do të përditësohet çdo vit, me qëllim që të sigurohet përshtatja e tij.

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë të ofruesve të shërbimeve postare, në përputhje me ligjin nr. 46/2015 dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, kryesisht Rregullores për Ofrimin e Shërbimit Universal

Postar, Rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm për ofrimin e Shërbimeve Postare, AKEP-i kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimit postar.

Dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit për Ofruesit e Shërbimit Postar për vitet 2024-2026”, i propozuar nga Grupi i Punës (DMKI) është i drejtë, i bazuar ligjërisht dhe në përputhje me synimet dhe funksionet e AKEP për përmbushjen e objektivave rregullatorë të përcaktuara në ligjin 46/2015, datë 07.05.2015.

Praktika dokumentare për shqyrtim të çështjes sipas objektit është paraqitur nga Grupi i Punës (DMKI) në përputhje me kërkesat procedurale të përcaktuara në nenin 12 të Rregullores së Brendshme të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Pasi e gjen dokumentin në përputhje me kërkesat ligjore në mbështetje të ligjit 46/2015, datë 07.05.2015, “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores Nr. 45, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë të Ofruesve të Shërbimeve Postare” dhe bazës ligjore sipërcituar,

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentin “Plani Strategjik i Inspektimit për Ofruesit e Shërbimit Postar për vitet 2024-2026”.
2. Ky Vendim dhe “Plani Strategjik të Inspektimit për Ofruesit e Shërbimit Postar vitet 2024-2026” të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Tomi Frashëri

Anëtar

Edlira Dvorani

Anëtar

Lorenc Bako

Anëtar

Bleron Dokle

Anëtar

Armer Juka



Adresa: Rr. “Rostin Collaku” Tiranë, Tel : + 355 4 2259 571 Fax : + 355 4 2259 106, www.akep.al, info@akep.al